



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 52

Datë: 05. 10. 2017, ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.49/2017

2.Aktivitetet e ZRPP-së;

- Shqyrtimi dhe miratimi i akreditimit të vëzhguesve për zgjedhjet lokale 2017

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore,

-Shqyrtimi i zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit komunal në Vushtrri

4 . Të ndryshme

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.49/2017

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 52 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush vërejtje lidhur me agjendën?

Betim Gjoshi: Kryetare nëse më lejon, në qoftë se veç ka pasur ndonjë zhvillim për një javë në Sekretariat, rendi ka qenë me pas një njoftim për aktivitetet e tyre, qysh e kemi kërkuar.

Valdete Daka: Kryeshefi na njofton. Atëherë, e fusim në rend të ditës edhe zhvillimet në Sekretariat.

Adnan Rrustemi: Pajtona që pa material nuk mundemi as me diskutuar por, një prezantim për zbatimin e planit operacional kryeshefi mundet me na një konfirmuar, së paku që po realizohen aktivitetet, janë siguruar materialet etj.

Valdete Daka: Kush është për këtë agjendë? Faleminderit...

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.49/2017

Valdete Daka: Pika e parë, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 49. A ka dikush vërejtje për këtë procesverbal? Nëse jo, kush është për miratimin e këtij procesverballi?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e KQZ-së, nr.49/2017

Valdete Daka: Faleminderit. Shkojmë me pikën e dytë. Aktivitetet e ZRPP-ës. Urdhëro Valmira...

2.Aktivitetet e ZRPP-së

Shqyrtimi dhe miratimi i akreditimit të vëzhguesve për zgjedhjet lokale 2017

Valmira Selmani: Faleminderit kryetare. Të nderuar anëtarë, zyra ka përgatitur për akreditim të vëzhguesve grupi i 5, duke u bazuar në nenin 54 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, neni 19 të ligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës dhe neni 3 për të rregullit zgjedhor 07/2013. Janë proceduar deri në 3 nëntor 2017, aplikacionet për vëzhgues të grupit të 5 atë duke përfshirë 13 parti politike. Zyra ka proceduar aplikacionet për akreditim të vëzhguesve me grupin e 5 dhe atë duke i përfshirë parti politike, 3 kandidatë të pavarur, 2 nisma qytetare, 4 organizata joqeveritare vendore, 2 organizata ndërkombëtare, 4 media, 3 ambasada dhe 2 institucione të huaja duke përfshirë edhe një koalicion ku janë të përfshirë në grupin e 5 për akreditim, 6258 vëzhgues. Aplikacioni është verifikuar dhe janë në rregull, pjesë e rekomandimit është edhe lista ku janë përfshirë emri i organizatës së vëzhguesve, lloji i organizatës dhe numri i vëzhguesve. Emrat e vëzhguesve janë të vendosur në CD. Faleminderit.

Valdetet Daka: Faleminderit...I keni para jush emrat e të gjithë organizatave që kanë aplikuar pra, gjithsejtë 6548. Po urdhëro...!

Betim Gjoshi: Nëse më lejohet, ndoshta ka qenë mirë me na tregu a kemi vëzhgues që janë duke pritur me kry fazën e verifikimit edhe e dyta, ka një ankesë prej krejt organizatave, sidomos prej këtyre që po aplikojnë me shumë vëzhgues, se kompania që po prodhon këta disnjiktiva nuk është duke e bërë ndarjen e këtyre në bazë të listës së certifikuar, dhe po ju nxjerr jashtëzakonisht shumë punë...Ju e dini që i kanë të ndamë bazuar në komuna, dhe ajo nuk po ndodh d.m.th., po ju merr jashtëzakonisht shumë angazhim edhe staf me nda, kur dihet që ata e dorëzojnë një listë edhe po ju ngatërrohen emrat, po kanë problem me administrimin e tyre. Ka qenë mirë, tha z. Gjoshi me kërkuar që të paktën për këta që këta që i miratojmë sot me bo ndarjen edhe sistemimin ata. Organizatat, subjektet të gjitha d.m.th. edhe OJQ-ët që kanë shumë njerëz të njëjtën problematik e kanë të gjithë. Faleminderit.

Valmira Selmani: Zyra, e ka edhe një pjesë të vëzhguesve në verifikim ku subjektet politike kanë sjell korrigjimet e tyre dhe do të procedohen në grupin tjetër, ndërsa për ndarjen do të kërkojmë nga kompania që ti ndajnë në bazë të komunave qysh i kanë specifikuar subjektet politike dhe organizatat që të kenë lehtësim për shpërndarjen e ID-ve. Faleminderit.

Adnan Rrustemi: Edhe një çështje nuk e di mbase jeni duke punuar: një udhëzues me informacione të përgjithshme për vëzhguesit me përgatitë, po e zëmë, numri i vendvotimit për shpërndarje, numri i votuesve, të drejtat e vëzhguesve, detyrimet e vëzhguesve, përgjegjësit e tyre etj. Kjo, vlen më shumë për vëzhguesit ndërkombëtar por pse jo edhe për vëzhguesit vendor edhe me ja shpërnda organizatave vëzhguesve në këtë rast para ditës së zgjedhjeve që mi pas të qarta për shpërndarjen e procesit zgjedhor në tërësinë e vendit por edhe disa detyrime dhe përgjegjësi dhe të drejta.

Valdete Daka: Po Valmirë, kishte me qenë mirë që këtu që ka vëzhgues të cilët vijnë edhe nga shtetet e tjera të cilët, do ta bëjnë vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve po ashtu vëzhgues nga ambasadat të akredituara në Kosovë. Siç e thash, ka disa shtete, KQZ-të e disa shteteve të cilat kanë aplikuar për akreditim. Kishte me qenë mirë që me përgatit një udhëzues edhe për ata edhe për vëzhguesit vendor. Atëherë kush është që të akreditohen numri prej 6548 vëzhgues gjithsej, emrat i keni në CD. Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër, këshilli për çështje ligjore. Urdhëro Sami....!

3.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi i zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit komunal në Vushtrri

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Në mbledhjen e Këshillit për Çështje Ligjore, është shqyrtuar kërkesa e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë për zëvendësimin e një anëtarit të kuvendit. E kemi shqyrtuar lëndën dhe, plotësohen gjitha kushtet ligjore që ky zëvendësim të bëhet edhe një sqarim shtesë nëse është më tepër për opinion. Edhe pse jemi në fushatë, faktikisht në shpallje të zgjedhjeve, kuvendet komunale janë funksionale deri në momentin e konstituimit të kuvendeve të reja, prandaj plotësohen gjitha kushtet që ky zëvendësim të bëhet...

Valdete Daka: Faleminderit, atëherë kush është që Besart Hajredinaj të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal të Vushtrrisë nga subjekti politik AAK - LDD, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Rrahim Ajeti.

Anëtarët e KQZ me vota unanime miratuan këtë rekomandim për zëvendësim të asamblistit nga KK i Vushtrrisë

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për pagesat e stafit të angazhuar në qendrat e votimit dhe vendvotime për zgjedhjet lokale 2017.

Valdete Daka: Para jush e keni një draft vendim të zakonshëm sikurse për gjitha zgjedhjet dhe pagesat, shumat për pagesa të këtyre anëtarëve.

Betim Gjoshi: Para se me miratuar, me siguri na jep krye shefi edhe një qëndrim nëse ka ndonjë ndryshim prej herës së kaluar. Por unë desha ta theksoj një problem të cilin e kemi pasur në zgjedhje të përgjithshme edhe po vazhdojmë nëse nuk marrim masa me pas edhe në këto. Problemi është i dy anshëm, problemi i par është për të cilin kisha kërkuar që mu angazhuar edhe një here kryetare që personat që vijnë nga kategoritë sociale si veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe persona të tjerë që angazhohen si staf i punës që janë mbi 22000 vetë në zgjedhje që mos të ju ndalet pagesa për shkak të angazhimeve të tyre në zgjedhje. Kjo ka ndodhur edhe në zgjedhjet e 11 shtatorit, për kundër përpjekjeve tona është mirë edhe një here me biseduar me ministrin e financave, ministrin e mërqinjës sociale që me adresuar këtë çështje.

Ndoshta, tha z. Gjoshi, zgjedhjet e përgjithshme kanë qenë të zënë, sepse kanë qenë në fushat duke u bazuar në këto zgjedhje lokale kanë mundësi ti qasen më seriozisht, mos t'i penalizojnë këta njerëz që mos të kontribuojnë në këtë proces zgjedhor. E dyta, e kemi edhe një problem të brendshëm dy muaj pas zgjedhjeve kemi pasur probleme besa edhe sot kemi hala njerëz që kanë probleme me pagesat e komisionarëve, e di që keni marr disa masa ku i kushtoni rëndësi kësaj mos të përsëritet duke pasur parasysh që jemi në fund të vitit, nuk kemi buxhet në vitin e ardhshëm me i paguar edhe na ndodhin probleme më të mëdha. Mund të ndodhen edhe vonesa më të mëdha. Ne, ndaj këtyre njerëzve po kërkojmë që të jenë të përgjegjshëm në punën e tyre duhet njëjtë edhe ne ti përgjigjemi edhe ti kryejmë gjitha obligimet e tona. Nëse konsideroni se ndonjë kategori prej tyre është e dëmtuar me pages për shkak të ndalesave që ju bëhen tatime dhe çështje tjera, është mirë buxheti është i miratueshëm në këtë fazë mundeni me na pruar propozim tjetër. Për ndryshe unë qoftë se është i njëjtë e përkrahi, por me zbrit nuk ka qenë mirë asnjëri nga këta që angazhohen në zgjedhje, faleminderit.

Adnan Rrustemi: Pata edhe unë pak a shumë të njëjtat çështje, d.m.th., ajo ndalesa që po bëhet personave që janë në skena sociale duke ia konsideruar si pagë, e me u sqaruar me ministrin e punës, e kuptoj që me një anë nuk është e drejtpërdrejtë në këtë aspekt po duhet të paktën për mungesë sqarimi mos me shkuar kjo çështje, e dyta unë personalisht kam marr do si me than ankesa e kërkesa për sqarim që në këto zgjedhjet e fundit ka pasur ndalës mbi këtë shumë... Diçka që s'ka ndodh me sa më kanë thënë, se di saktë, në zgjedhjet e mëparshme d.m.th., a është tatim a është mbi të hyrat a mbi pagën...? Nuk e di, edhe këtu duhet me sqaruar se, a duhet me ju nënshtruar tatimit kjo pagesë a jo, dhe nëse duhet me ju nënshtruar, duhet me ju nënshtruar mbas me e rritë e me kompensuar qatë pjesën e ndalesës, dhe e treta që ndërlihet me punën në pagesë... Është e vërtet që ne kemi ende raste që nuk

janë paguar. Përfundimisht komisionarët, dhe për zgjedhjet lokale përveç se janë në fund të vitit, dhe mund të kemi telashe me pagesa në përmbylljen e tyre. I kemi edhe dy raundet të cilat, edhe po ja ua kujtoj një vendim që e kemi marr që kryesuesi i këshillave të vendvotimeve për raundin e dytë, me qenë në përbërje tjetër, dhe kjo nënkupton: pak me ndërliko edhe administrimin e pagesave sepse, ndryshojnë pozicionet, ndryshojnë pagesat d.m.th., i njëjti person në raundin e parë mund të ketë pagesë tjetër, ka pozicion tjetër në raundin e dytë dhe mund të ketë pagesë tjetër se..., ka pozicion tjetër. Duhet me i trajtua me një lloj serioziteti që me kanë ma efikas në të dhënat që pranohen gjatë nominimit, edhe që pagesat me u përmbyllë sa më parë, e jo me prit me 3 muaj a 4 muaj...

Enis Halimi: Faleminderit kryetare, për sa i takon çështjen që u ngrit këtu, ju njoftoj se ndryshimi nga zgjedhjet e fundit në kuptim të pagesave nuk ka nga kjo listë...Për sa i takon çështjes, që ndalesave të kategorive që u cekën edhe ma herët, kemi marr iniciativë dhe kemi komunikuar dhe ju kemi adresuar pyetjeve edhe ministrin edhe zyrtarëve ligjor...Në ministri, e prej të cilëve kemi marr konfirmonim se për disa kategori dhe ju kemi shpjeguar d.m.th., në ato adresimet tona ju kemi shpjeguar që kjo është pagesë e njëhershme, pagesë që bëhet për këtë qëllim pra, vetëm për periudhën e zgjedhjeve dhe nuk është pagë e rregullt, nuk është e hyrë e rregullt.

Ata, tha z. Halimi, kanë kthyer përgjigje nga zyra ligjore të cilën unë mund ta ndaj me ju. Për sa i takon vonesave, ne sivjet i kemi tash këto zgjedhje e kemi si përvojë kemi filluar me praktikuar që vetë stafi i komisionarëve të merr përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave, për shkak se ne shpesh jemi ballafaquar te këto pengesa jemi ballafaquar me atë se llogaritë nuk kanë qenë aktive sa do që i kanë pru vërtetimin edhe numrin e llogarive...Përveç kësaj, një problem tjetër që e kemi evidentuar gjate këtyre zgjedhjeve, është se disa banka nuk po hapin më llogari për persona privat nëse nuk është në listë të pagave pra, në listë të rregullt të pagave dhe kemi probleme të këtyre lloj natyrave. Prej fillimit bëhet pagesa për këto kategori, bëhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe tatimit. Prej herës së fundit, ndoshta me ndryshimin e rregullativës, këto obligohen tatimohen, dhe tatimi më herët ka qenë deklarim vullnetar...Kjo është çështja...

Ercan Spat: Faleminderit kryetare. Dëgjuam prej krye shefit dhe kolegëve besa shumë detaje për shumë pengesa në institucionet e Kosovës në lidhje me pagesën e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve edhe të tjerëve të cilët kanë nevojë për pagat. Krye shefi përsëriti disa probleme të cilat kanë has, mu po më intereson çfarë probleme kanë në brendësi, sekretariati jon, ku jemi ne në tërë këtë proces, në tërë këto lëshime, se shembull konkret e kam një rast u paraqit te unë ka pasur gabime s'po dihet ende sot ku ka dështuar në atë zingjirin e pagesës. Deri sot nuk e ka marr pagesën por, edhe në zgjedhjet 2014 ka pasur njëjtë edhe kurrë nuk i ka marr paret, po përsëritet e njëjta. A është problemi te ne a ku? Ato gjëra duhet të hulumtohen, dobësitë tona ne ti eliminojmë.

Adnan Rrustemi: Unë propozoj që me u rrumbullaku shuma, se janë kështu pak të ndara, nuk e di ku qëndron arsyetimi i tyre, por, edhe për atë masën e tatimit që ju ndalet unë personalisht nëse ka gjithmonë buxhet kisha propozuar m'u rrumbullaku d.m.th., nga 33.5, le të bëhet 35 në këtë rast për kryesuesit, e kështu me radhë...

Valdete Daka: Janë 25 mijë njerëz, me qenë një kish me qenë më lehtë. Edhe pjesa më e madhe e bugjetit për zgjedhje shkon në pagesa.

Sami Hamiti: Unë më tepër për kujtim, si për kujtesë po d'u me thënë për situatën që të vjen dolën dikund me tërë përlllogaritjet dikund kah fundi i vitit fiskal edhe përfundon certifikimi me një afat

dikund. Afatin e keni shumë të shkurtër, unë po ju them që nëse nuk i procedoni me kohë mjetet dihet qysh i kanë marr me vite, po ti ngarkohesh vitin e ardhshëm zgjedhje nuk ke. Nga mallrat dhe shërbimet për situatat tjera nuk ke ma pas zgjedhje pa i paguar. Kështu që ato nuk ti bartin ty pse ti mundesh me ndonjë arsyetim çfarë do qoftë ta lësh pas 25 dhjetor, se përfundon viti fiskal, mjetet këto nga mallrat dhe shërbimet ku i ke, nuk i ke më i ke të planifikuara të buxhetit të vitit të ardhshëm dhe ti merr. Tani mujim me marr si situatë prandaj po tregoj, puna e komisionarëve edhe e këtyre kryhet me raundin e dytë po themi të balotazhit, kështu që keni kohë të mjaftueshme, një muaj mi bo pagesat e mos mi lënë asnjë për vitin e ardhshëm. Uroj që të bënë por, s'besoj që keni me bo por, po ta përkujtoj paraprakisht.

Valdete Daka: Kryeshef, ndoshta kishte qenë mirë që krejt këto pengesa që i thatë, gabimet me nis me i verifiku qysh tash, edhe ato që bankat nuk hapin llogari edhe me ja u shpjegua komisionarëve që duhet me pru llogarinë e vet e jo të vëllait e motrës sepse ka pas shume edhe asi raste.

Adnan Rrustemi: Ne të gjithë e dimë që kemi vështirësi kur bëhet fjalë për procesin në vendvotim sidomos për numërimin, sidomos për plotësimin e formularëve që nënkupton efikasitetin edhe performancën e kryesuesve. Personalisht unë kisha propozuar që me rishikuar shumë që i paguajmë kryesuesit. Mendoj që duhet në përputhje me përgjegjësinë me trajtuar edhe në aspektin e pagesës që të paktën ta ketë një dallim esencial edhe ta ketë një tretman serioz që në frymën e përgjegjësisë që ka edhe me paguar edhe me u sill si i tillë. Personalisht d.m.th. nëse gjithmonë ka buxhet të planifikuar që nuk na krijon implikime kisha propozuar me trajtuar në mënyrë pak më serioze d.m.th. këtu nuk ndërlihet kërkush.

Enis Halimi: Për këtë çështjen e lëvizjeve me shifrave, qoftë në kuptim të mbulimit të tatimit apo qoftë në kuptim të stimulimit të kryesuesve na duhen analiza për të projektuar shumë e cila eventualisht do të na kushtoj dhe implikimet për të llogaritur të gjitha implikimet që dalin nga ky propozim. Ndërkaq, për sa i takon kryesuesve, nëse secili kryesues e ngrit pagesën e tij për 10 euro, janë dikund aq kryesues sa ka vendvotime rreth 2505. 2500 herë 10 euro nëse e llogaritim 25 mijë euro plus raundi i dytë, i kemi dikund 50 mijë euro vetëm për 10 euro me kryesues nëse lëviz...Ky, është implikim që do të duhej me i bërë për llogaritjet se sa mjete i kemi. Ndoshta, nuk është si vendim i ngutshëm, mund të rishikohet, mund të ri konsiderohet edhe një herë në mënyrë që me dal me analiza. E 2014-ta, nëse ka ndonjë ndryshim, me sa më kujtohet të pagesa e këtyre të shpërndarje të materialeve, ndërkaq të tjerët janë të ngjashme...

Ndërkaq, tha z. Halimi, prej zgjedhjeve të fundit nuk ka asnjë ndryshim. Për sa i takon hallkave tona..., një çështje që e ngriti zoti Spat, ne e konsiderojmë që e kryejnë punën mirë por, me gjithë atë është volumi i madh i punëve që nuk besoj që ka kund në institucione që ballafaqohen me një numër kaq të madh të pagesave për një kohë shumë të shkurtër... Edhe në kuptimin kohorë, e edhe në aspekte të tjera. Kështu që ne e konsiderojmë që e kryejnë punën mirë, pa përjashtuar ndonjë ngecje eventuale që ndoshta për shkak të mundësive objektive të stafit që ti identifikojmë problemet me të cilat ata ballafaqohen. Faleminderit.

Betim Gjoshi: Ne, e kemi konsumuar këtë debatin dhe çështja është se qysh mundemi me e avancuar sekretariatit te pagesat....?

Valdete Daka: Atëherë kush është për këtë vendim? Sepse na duhet me marr një vendim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin për pagesat e stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit dhe Vendvotime për zgjedhjet lokale 2017.

Betim Gjoshi: Kryetare, ju kisha lut që si kryesuese e institucionit, seriozisht me marr bashkë me kryeshefin mi biseduar..., dhe jo veç mi bo pyetje institucioneve, por me biseduar dhe me e zgjidhë çeshtjen lidhur me ndalesat për personat që ju takojnë kategorive sociale, si veteranet e luftës edhe invalidët e luftës, familjeve të dëshmoreve edhe të tjerë që janë...dhe me i siguruar të dhënat, se këta persona për këtë arsye paguhen, dhe mos me ju ba ndalesa.... Se pagat që kanë, jonë sa 3-fishi që i paguajmë ne 60 euro ditën, e atyre ju ndalen 170 euro pagesë...!

4. Tw ndryshme

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
